

Asambleja Kombëtare drejton gjithë veprimtarinë e BSPSH-së në periudhën midis dy kongreseve.

- Asambleja Kombëtare ka të drejtë të miratojë përbërjen e Këshillit Kombëtar të BSPSH-së, Sekretarët dhe Zv/Presidentin, Përfaqësuesit e Komisionit të Interpretimit dhe Zbatimit të Statutit sipas normativave të përcaktuar nga Statuti.
- Analizon veprimtarinë e forumeve sindikale të BSPSH-s[e mbi këtë bazë harton e miraton platformat dhe politikat e aktivitetit sindikal për vitet e ardhshme.
- Përcakton detyrat afatmesme të karakterit kombëtar: si marrëveshjet në nivel kombëtar, miraton grevat në shkallë kombëtare, aderimet ndërkombëtare etj.
- Asambleja Kombëtare miraton programe e studime statistikore në mbështetje të zbatimit të politikave të saj sindikale, si të tregut të punës, të uljes së varfërisë, sigurimeve shoqërore e shëndetësore etj.
- Me dy të tretat e votave amendon statutin për nene të veçanta në rastet që diktohen nga zhvillimet e lëvizjes sindikale në vend.

Me propozim të Këshillit Kombëtar, vendos kooptimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar që janë larguar nga BSPSH për arsye të ndryshme.

Me propozim të Këshillit Kombëtar, vendos për aderimin në BSPSH të strukturave sindikale të reja ose të atyre, që janë larguar nga ky bashkim.

Asambleja Kombëtare e BSPSH ka të drejtë të marrë çdo lloj vendimi që ka të bëjë me strukturat sindikale të BSPSH-së dhe të tretëve përveç atyre, që janë normativa dhe detyrime kongresuale.